



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 109 Akti

Nr. 172 Vendimi

Tiranë, më 27.06.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Lulzim Hamitaj	Relator
Firdes Shuli	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në Tiranë, në datën 25 qershor 2019, në Pallatin e Koncerteve, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:

Znj. Alketa Nushi, prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.

OBJEKTI:

Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE:

Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatorit të çështjes, z. Lulzim Hamitaj, subjektin e rivlerësimit, vëzhguesin ndërkombëtar, si dhe pasi shqyrtoi dhe diskutoi në tërësi çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit, znj. Alketa Nushi, e cila në seancën dëgjimore publike të datës 25.6.2019, kërkoi konfirmimin e saj në detyrë,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

- i. Subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, për shkak të funksionit të saj si prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016¹.
- ii. Pas hedhjes së shortit, trupi gjykues nr. 1 – i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Lulzim Hamitaj dhe Firdes Shuli – pasi administroi dhe studioi tri raportet e institucioneve të parashikuara nga nenet 31–44 të ligjit nr. 84/2016, me vendimin nr. 1, datë 20.3.2018, vendosi: (i) të fillojë hetimin administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm sipas nenit 45 të po këtij ligji; (ii) të caktohet, me mirëkuptim, kryesuesi i trupit gjykues, znj. Alma Faskaj. Anëtarët e trupit gjykues deklaruan se nuk ishin në kushtet e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit.
- iii. Më pas, për arsye objektive pamundësie, në bazë të vendimit nr. 40, datë 16.7.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, “Për rishpërndarjen me short dhe transferimin e dosjeve të çështjeve të komisionerit Alma Faskaj”, nëpërmjet procedurës së shortit, anëtarja e trupit gjykues, komisionere Alma Faskaj, u zëvendësua nga komisionerja Etleda Çiftja.
- iv. Në vijim të hapave hetimorë, në datën 6 qershor 2019, me vendimin nr. 2, trupi gjykues vendosi të mbyllë fazën hetimore dhe, në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, vlerësoi që procesi i rivlerësimit për znj. Alketa Nushi, të bazohej në të tria kriteret e rivlerësimit dhe, përkatësisht: në kontrollin e pasurisë, të figurës dhe në atë profesional.
- v. Në datën 7.6.2019, Komisioni e njoftoi subjektin e rivlerësimit për: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të sjellë shpjegime dhe prova për të provuar të kundërtën, brenda datës 18 qershor 2019; (iii) për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 35 – 40 dhe 45 – 47 të Kodit të Procedurës Administrative.
- vi. Në mungesë të një përgjigjeje nga subjekti – edhe pse ishte detyrim i saj të verifikonte dhe të shikonte adresën zyrtare të *e-mail*-it – pasi znj. Alketa Nushi, e cila u shpreh se nuk i kishte marrë rezultatet e nisura nga Komisioni, në datën 11.6.2019 u kontaktua telefonikisht nga sekretarja gjyqësore – po në atë datë iu rinisën rezultatet, në po të njëjtën adresë zyrtare *e-mail*-i. Këtë herë subjekti i rivlerësimit e konfirmoi marrjen e tyre.
- vii. Pasi subjekti i rivlerësimit ishte njohur me dosjen, mori kopje dhe paraqiti një kërkesë për të pasur më shumë kohë për mbrojtjen e saj – edhe pse brenda afatit të caktuar ajo paraqiti parashtrimet e saj – trupi gjykues, pasi u njoh me kërkesat e subjektit, në datën 18.6.2019, vendosi të zgjasë afatin për paraqitjen e shpjegimeve dhe provave nga znj. Nushi, nga data 18.6.2019 deri në datën 24.6.2019, duke parashikuar paraprakisht edhe datën e senacës, 25 qershor 2019.

¹ Paragrafi 3, i nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “Ligji nr. 84/2016”), parashikojnë se: “*Të gjithë gjyqtarët, duke përfshirë gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, të gjithë prokurorët, duke përfshirë Prokurorin e Përgjithshëm, Kryeinspektorin dhe inspektorët e tjerë pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, i nënshtrohen rivlerësimit ex officio*”.

- viii. Në datën 18.6.2019 subjekti i rivlerësimit ka kërkuar të njihet me shkaqet e administrimit të dosjeve profesionale nga Komisioni, si dhe me të gjitha denoncimet që referonin procedimet në fjalë. Po në të njëjtën datë, Komisioni i përcolli subjektit me *e-mail* katër denoncime, të cilët nuk kishin qenë pjesë e materialit në CD-në që subjekti kishte tërhequr pranë Komisionit dhe, në respektim të të drejtave të saj, i dha kohë shtesë për vlerësimin e tyre, si dhe për të paraqitur shpjegime, nëse do ta konsideronte të nevojshme.
- ix. Në datën 19.6.2019 subjekti i rivlerësimit, pasi ishte njohur me të gjithë materialin e dosjes, në bazë të të cilit ishin arritur rezultatet e hetimit – edhe pse paraqiti shpjegimet e veta të shoqëruara me dokumentacion mbështetës mbi rezultatet e hetimit kryesisht – shprehu pamjaftueshmërinë e kohës për plotësimin e dokumentacionit në mbështetje të mbrojtjes së saj.
- x. Në vijim, Komisioni i bëri me dije subjektit se:
- lidhur me rezultatet e kriterit të figurës është hequr barra e provës, duke e ftuar subjektin që të paraqesë shpjegime;
 - afati për paraqitjen e shpjegimeve dhe të provave shtyhej nga data 18.6.2019, në 24.6.2019, dhe njëkohësisht u paralajmërua caktimi i datës së seancës, 25.6.2019, ora 10:00;
 - sqarohej se administrimi i dosjeve profesionale është bërë në vijim të denoncimeve të publikut, por edhe të indiceve apo informacioneve që Komisioni ka marrë nga organet ligjzbatuese (siç ishte specifikuar edhe në faqen 24, paragrafi i parë, të rezultateve të hetimit administrativ të Komisionit), për rrjedhojë, jo për çdo dosje të administruar duhej të kishte detyrimisht një denoncim nga publiku dhe se Komisioni kishte detyrimin e ruajtjes së konfidencialitetit, kur ishte rasti.
- xi. Më pas, në datën 21 qershor, subjekti paraqiti një tjetër kërkesë me *e-mail* dhe trupi gjykues, pas shqyrtimit të pikëkërkesave të saj, vendosi si në vijim:
- administrimin e të gjitha provave shkresore të paraqitura nga subjekti, për t'i vlerësuar më tej së bashku me dokumentacionin përkatës;
 - në bazë të germës “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, të mos e pranojë kërkesën lidhur me pritjen dhe administrimin e përgjigjeve të institucioneve, tek të cilat subjekti ka paraqitur kërkesë për informacione shtesë, pasi ato në objekt vlerësohen të panevojshme për vendimmarrjen, nga momenti që institucionet në fjalë i kanë shprehur konkluzionet e tyre dhe Komisioni ka kryer hetime të pavaruara;
 - gjithashtu, në bazë të germave “a”, “c” dhe “d” të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, të mos të pranojë kërkesën për dëgjuesin e disa personave si dëshmitarë, pasi – përtej pamundësisë *ipso jure* që këtyre dëshmitarëve të mund t'i drejtoheshin pyetje direkte mbi rrethana dhe informacione të klasifikuara – faktet në fjalë për të cilat mund të shpreheshin dëshmitarët, nuk kanë qenë pjesë e barrës së provës dhe gjithsesi trupi gjykues ka pasur akses në informacione dhe në dokumente të tjera mbi të cilat mund të krijonte bindjen e tij të brendshme.
- xii. Në datën 24.6.2019, pasi subjekti paraqiti shpjegime shtesë dhe dokumente të tjera në mbështetje të mbrojtjes së vet, trupi gjykues konfirmoi datën e parashikuar për seancë dhe vendosi të ftojë – përmes postës elektronike – subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në

përputhje me nenin 55, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit u njoftua se sipas parashikimeve, seanca dëgjimore do të zhvillohej në datën 25.6.2019 – datë në të cilën u zhvillua rregullisht, ku subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm, pa përfaqësues, dhe paraqiti gjerësisht shpjegimet dhe argumentimet e saj.

II. SEANCA DËGJIMORE

- i. Seanca dëgjimore e datës 25 qershor 2019 – për subjektin e rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs.
- ii. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni, përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit – dhe të kaluara si barrë prove apo për shpjegime.
- iii. Znj. Alketa Nushi, pasi dëgjoji relacionin, shprehu qëndrimin e vet, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.
- iv. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, gjatë seancës dëgjimore, u përgjigj pyetjeve të bëra nga trupi gjykues dhe nga vëzhguesi ndërkombëtar, si dhe shprehu qëndrimin e vet përfundimtar të argumentuar dhe në konkluzion, kërkoi konfirmimin në detyrë;
- v. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin, znj. Alketa Nushi, duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.
- vi. Seanca dëgjimore e datës 25.6.2019 u ndërpre, për të rifilluar në datën 27.6.2019 për shpalljen e vendimit.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

Znj. Alketa Nushi ka mbajtur një qëndrim bashkëpunues me Komisionin, duke dhënë përgjigje sa herë është pyetur dhe ka paraqitur dokumentacion mbështetës për shpjegimet e veta, edhe në lidhje me burimet financiare të personave të tjerë, me të cilët kishte pasur marrëdhënie financiare.

IV. HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu një hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) provat e dorëzuara nga vetë subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Veting”;
- b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja;
- c) raportet dhe informacionet mbi kontrollin e figurës, të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja;
- d) provat shkresore/dokumentet të/e administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- e) deklaratimet dhe përgjigjet e subjektit të rivlerësimit, të bëra me anë të komunikimit elektronik me Komisionin;

- f) shpjegimet me shkrim dhe dokumentacionin mbështetës, të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit pas njoftimeve të mbylljes së hetimeve administrative, si dhe argumentimeve verbale të bërë nga subjekti në seancën dëgjimore – për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit;
- g) deklaratimet e personave të lidhur apo të tjerë të lidhur;
- h) faktet e njohura botërisht.

A. PROCESI I RIVLERËSIMIT PËR KRITERIN E PASURISË

Bazuar në nenet 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja ka dërguar me shkresën nr. *** prot., datë 12.2.2018, raportin lidhur me deklaratimet dhe vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, ku konstatohet se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti i rivlerësimit nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Komisioni ka hetuar në mënyrë të pavarur mbi çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse mbi të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016.

Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë konsistoi në: verifikimin e vërtetësisë së deklaratimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme, të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklaratimeve të rreme apo të ndonjë konfliktit të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

1. Për pasuritë e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për rivlerësim, në zbatim të ligjit nr. 84/2016

- Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar:
 - i. **Katër pasuri tokë arë**, në *** (***, Vlorë), gjithsej me sip. 9164 m² (1302 m² + 2655 m² + 3600 m² + 1607 m²), pjesa takuese: 33,3 %, të përfituara si anëtare e familjes bujqësore, në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”. Kjo tokë rezulton me sip. 177 m² më shumë nga sa është deklaruar në vitin 2008.
 - ii. **Tokë truall, me sip. 250 m²**, me vendndodhje po në *** (***, Vlorë), pjesa takuese: 33,3 %. Edhe kjo pasuri është deklaruar si e përfitur në bazë të ligjit nr. 7501/1991. Kjo pasuri nuk rezulton që të jetë deklaruar më parë nga subjekti.
 - iii. **Apartament banimi me sip. 70 m²**, me vendndodhje: Njësia Bashkiake ***, Tiranë, sipas kontratës së porosisë datë 29.9.2008, me vlerë 32.900 euro; pjesa takuese: 50 % subjekti dhe 50 % bashkëshorti i saj.

Burimi i krijimit të kësaj pasurie: 25.000 euro nga kredia bankare e marrë në “Tirana Bank”, në datën 3.11.2008; ndërsa 7.900 euro kishin për burim krijimi: 3.900 euro kursime

personale nga puna e mëparshme; 2.000 euro ishin dhuruar (si ndihmë financiare) nga motra e bashkëshortit të subjektit, znj. A. Ç. dhe 2.000 euro ishin dhuruar (si ndihmë financiare) nga nëna e subjektit, znj. N. N.

- iv. **Automjet, marka “Ford Focus”**, prodhim i vitit 2002, dhuruar nga vëllai i subjektit, z. S. N.
- Ndërkohë, në deklaratën e vitit 2008, para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit kishte deklaruar:
 - i. Tokë arë, me sip. 8987 m², fshati ***, Vlorë. Pjesa takuese: 33 %, përfituar si familje bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501/1991, “Për tokën”.
 - ii. Vreshtë, me sip. 1600 m², fshati ***, Vlorë. Pjesa takuese: 33 %, përfituar si familje bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501/1991.
 - iii. Ullishtë, me sip. 1500 m², fshati ***, Vlorë. Pjesa takuese: 33 %, përfituar si familje bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501/1991.
 - iv. Apartament, me sip. 70 m², ***, Tiranë. Blerë sipas kontratës së porosisë nr. ***, datë 29.9.2008, me vlerë **32.900 euro** ose **4.052.704** lekë, shumë e cila është paguar **25.000 euro** me kredi bankare në “Tirana Bank”, **4.000 euro** ndihmë nga familjarët dhe pjesa tjetër me të ardhurat e veta.
 - v. Në deklaratën para fillimit të detyrës, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë një gjendje prej **432.777** lekësh në llogaritë bankare. Këtu janë përfshirë edhe llogaritë e biznesit të bashkëshortit, duke qenë se forma juridike e organizimit është person fizik, çka nënkupton që të drejtat dhe detyrimet janë të pakufizuara.
 - vi. Të ardhura nga pagat dhe aktiviteti i biznesit për subjektin e rivlerësimit dhe bashkëshortin deri në vitin 2008, të deklaruar janë **1.655.128 lekë**, ndërkohë që të ardhurat e dokumentuara janë **1.891.903 lekë**.
 - vii. Subjekti nuk ka deklaruar kursime *cash*.
- Duke konsideruar se në vitet e ndërmjetme përgjatë periudhës 2008 – 2017, nga subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur asnjë deklaram pakësimi apo tjetërsimi të pasurisë së paluajtshme, nga analiza dhe krahasimi i dy deklaramëve të sipërpërkshkruara, Komisioni ka konstatuar disa mangësi dhe mospërputhje si më poshtë:
 - i. Në deklaratën “Vetting” është deklaruar truall me sip. 250 m², i cili nuk rezulton të jetë deklaruar në vitin 2008, edhe pse subjekti e përshkruan përftimin e kësaj pasurie në bazë të ligjit nr. 7501/1991.
 - ii. Gjithashtu, kanë lindur dyshime mbi mundësinë dhe ligjshmërinë e përftimit të një trualli nëpërmjet ligjit nr. 7501/1991.
 - iii. Në deklaratën “Vetting” është deklaruar 177 m² sipërfaqe tokë arë më shumë nga ajo që ishte deklaruar në vitin 2008 – para fillimit të detyrës.
 - iv. Në deklaratën “Vetting” nuk janë deklaruar pasuritë: vreshtë, me sip. 1600 m² dhe ullishtë, me sip. 1500 m², të cilat ishin deklaruar në vitin 2008 dhe nuk rezulton që ndërkohë – së paku deri në deklaratën “Vetting” – të jenë deklaruar tjetërsime (shitje apo dhurime) të këtyre pasurive nga subjekti.

- v. Në deklaratën e vitit 2008, para fillimit të detyrës, nuk është deklaruar burimi financiar i krijimit të apartamentit, ndonëse ky detyrim ishte i përshkruar qartë në paragrafin pararendës, si dhe në krye të rubrikës së përshkrimit të pasurive dhe të burimit të krijimit të tyre.

Në deklaratën e vitit 2008, para fillimit të detyrës, nuk rezulton të jenë deklaruar dy shumat prej 2.000 eurosh secila, të përfituara/marra si dhuratë (ndihmë financiare e pakthyeshme), nga nëna dhe kunata e subjektit, të përdorura për blerjen e apartamentit, me sip. 70 m², në ***, Tiranë, në datën 29.9.2008.

Lidhur me burimet e krijimit të kësaj pasurie, Komisioni ka kryer hetimet administrative, nga ku ka rezultuar se pagesat ishin kryer sipas deklaramentit të bërë nga subjekti, dhe konkretisht:

- a. Shuma prej 25.000 eurosh rezultoi e paguar nga kredia bankare e marrë nga “Tirana Bank”, në datën 3.11.2008;
- b. Shuma prej 3.900 eurosh buronte nga kursime personale nga puna e mëparshme – fakt ky i verifikuar nga Komisioni dhe ka rezultuar se subjekti i kishte mundësitë për këto burime financiare të ligjshme në momentin e blerjes së apartamentit;
- c. Shuma prej 2.000 eurosh rezultonte e deklaruar si e dhuruar (si ndihmë financiare) nga e motra e bashkëshortit të subjektit, znj. A. Ç., e cila e ka konfirmuar këtë rrethanë nëpërmjet deklaratës noteriale, si dhe ka treguar mundësitë e saj financiare për të poseduar në mënyrë të ligjshme shumën e dhuruar;
- d. Diferenca prej 2.000 eurosh rezultoi e deklaruar si e dhuruar (si ndihmë financiare) nga nëna e subjektit, znj. N. N., e cila e ka konfirmuar këtë rrethanë nëpërmjet deklaratës noteriale, si dhe ka treguar burimin e ligjshëm të posedimit të shumës që i ka dhuruar vajzës së saj.

Për rrjedhojë, Komisioni nuk ka konstatuar problematika lidhur me burimet e ligjshme financiare, të përdorura nga subjekti për blerjen e këtij apartamenti.

Subjektit i ishte kërkuar të sqaronte vetëm mosdeklarimin e këtyre dhurimeve në deklaratën para fillimit të detyrës, por ajo ka shpjeguar, në mënyrë bindëse, se nuk e kishte këtë detyrim, pasi shumat në fjalë ishin marrë dhe ishin përdorur për blerjen e apartamentit përpara se ajo të fillonte detyrën që e bënte subjekt deklarues. Edhe nga dokumentacioni i administruar nga Komisioni ka rezultuar se subjekti e ka blerë apartamentin në shtator 2008, ndërkohë që subjekti është emëruar në nëntor 2008.

- vi. Lidhur me automjetin e markës “Ford Focus”, prodhim i vitit 2002, Komisioni pas administrimit të dokumentacionit përkatës ka konstatuar se – në përputhje me sa kishte deklaruar subjekti i rivlerësimit – kjo autoveturë ishte dhuruar nga vëllai i subjektit, z. S. N. – ky automjet kishte qenë më herët në posedim të dhuruesit, i cili i kishte pasur mundësitë financiare për blerjen e tij.

Në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie – automjetin e markës “Ford Focus”, prodhim i vitit 2002 – dhe me deklarimin e saj Komisioni nuk konstatoi problematika apo mospërputhje.

1.1 Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

- i. Lidhur me mospërputhjen e sipërfaqeve të tokave të deklaruara në deklaratën “Vetting” me ato të deklaruara para fillimit të detyrës, subjekti shpjegoi se ky fakt nuk varej nga vullneti apo nga mangësia e saj, por nga gabimet e institucioneve kompetente. Ajo shtoi se është fakt i njohur se dokumentet dhe të dhënat e AMTP-ve nuk kanë qenë shumë të sakta dhe se nga verifikimet e mëpasshme, gjatë procesit të regjistrimit, ZVRPP-të kanë kryer korrigjimet e duhura. Deklarimet në vite kanë pasqyruar pasuritë e përshkruara në AMTP dhe, në deklaratën “Vetting”, është shkruar me saktësi çdo pasuri sipas certifikatës dhe sipërfaqes përkatëse. Subjekti ka paraqitur dokumentacion lidhur me tokat në fjalë.
- ii. Për sa i takon mënyrës së përfitimit dhe mosdeklarimit në deklaratën para fillimit të detyrës të truallit me sip. 250 m², subjekti ka sqaruar se ai është marrë në përputhje me germën “c”, të nenit 1, të ligjit 7501/91, si pjesë përbërëse e truallit/oborrit të një banese ekzistuese. Mosdeklarimi i tij më herët shpjegohet nga mospasja asokohe e certifikatës së pronësisë për këtë pronë.
- iii. Lidhur me tokat ullishtë dhe vreshtë, subjekti shpjegoi se mospërputhja ka lindur nga pamundësia për t’i regjistruar si pronësi këto toka – pasi, sipas dispozitave ligjore, ato vijonin të konsideroheshin si sipërfaqe në bashkëzotërim nga të gjitha familjet bujqësore dhe, për rrjedhojë, nuk lejohej copëzimi pasuror. Ajo ka shtuar se, duke jetuar në Tiranë, nuk i ka kultivuar apo shfrytëzuar ato toka.
- iv. Së fundmi, lidhur me këtë pikë, subjekti ka nënvizuar faktin se në emër të subjektit rezulton e regjistruar më pak tokë sesa ishte përfituar sipas AMTP-ve dhe, për rrjedhojë, nuk ka asnjë shtim pasurie të dyshimtë në favor të saj.
- v. Për sa i përket mosdeklarimit të dy dhurimeve – secili prej 2.000 eurosh – që subjekti ka përfituar nga të afërmit e vet, znj. Alketa Nushi, ka shpjeguar se shumat në fjalë janë marrë në shtator 2007 dhe në qershor 2008, ndërsa ajo është emëruar në funksionin e prokurorit në nëntor 2008, ndaj, për rrjedhojë, nuk kishte detyrimin që t’i deklaronte.

1.2 Vlerësimi i trupit gjykues

- i. Komisioni vlerëson se subjekti ka shpjeguar bindshëm faktin se deklarata “Vetting” është e bazuar në dokumentacion provues dhe se mospërputhjet e sipërfaqeve të tokës të pasqyruara më herët në AMTP, në momentin e ndarjes së tokës sipas ligjit 7501/1991, dhe më pas në certifikatat e pronësisë, janë pasojë e pasaktësive të dokumenteve, si dhe të veprimeve të organeve kompetente, pra, nuk vareshin nga veprimi apo mosveprimi i subjektit. Në të dyja rastet subjekti ka përshkruar sipërfaqet e shënuara në dokumentacionin e sipërcituar dhe, për rrjedhojë, nuk mund të konsiderohet në shkelje.
- ii. Gjithashtu, rezulton e provuar nga subjekti se edhe sipërfaqja truall me sip. 250 m², është përfituar në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe që regjistrimi i tij nuk ishte kryer ende në vitin e deklarimit para fillimit të detyrës.
- iii. Trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer një deklaram të pamjaftueshëm lidhur me tokën vreshtë me sip. 1.600 m², të ndodhur në ***, Vlorë, me pjesë takuese 33%, dhe ullishtë me sip. 1.500 m², me të njëjtën vendndodhje dhe pjesë takuese, të përfituara si familje bujqësore në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991. Ky konkluzion rrjedh nga fakti që subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin që të deklaronte të gjitha pasuritë e luajtshme dhe të paluajtshme në pronësi, në posedim apo në përdorim, dhe dy pasuritë në fjalë, për pjesën takuese 33%, sigurisht që kanë qenë në posedim të subjektit, së paku *de*

jure, duke qenë se këto janë përfituar nga ligji nr. 7501/91, dhe nuk rezultojnë as të jenë tjetërsuar dhe as të jenë në posedim të ndonjë shoqërie apo individit jashtë familjes buqësore. Komisioni çmon se mos punimi, shfrytëzimi, apo mospërfitimi i fryteve nga një send, – përtej faktit se kjo mund të jetë realizuar edhe në mënyrë indirekte – nuk e përjashton subjektin nga detyrimin për të deklaruar posedimin e tij.

2. Analiza financiare

Nga analiza financiare e kryer nga Komisioni për periudhën deri në vitin 2008, ka rezultuar se subjekti ka pasur të ardhura të ligjshme, të mjaftueshme për shpenzimet e kryera.

Lidhur me analizën financiare për vitet në vazhdim, ka rezultuar se:

- i. **Për vitin 2009**, nga analiza financiare e të ardhurave dhe e shpenzimeve të kryera, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme për të përballuar shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.
 - a. Por ka rezultuar se të ardhurat nga pagat dhe nga biznesi i bashkëshortit të subjektit për vitin 2009 janë deklaruar në vlerën 1.266.138 lekë, ndërkohë që të ardhurat e dokumentuara janë në vlerën 1.196.421 lekë.
 - b. Gjithashtu, ka rezultuar se në deklaratën periodike vjetore për vitin 2009 lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit janë deklaruar të ardhura në vlerën 450.000 lekë, ndërsa fitimi *neto* sipas dokumenteve ka rezultuar në vlerën 345.870 lekë, kurse të ardhurat *bruto*, sipas dokumenteve të biznesit, kanë qenë në vlerën 1.700.000 lekë.
 - c. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, nga subjekti janë vënë në dispozicion fatura tatimore shitje, të cilat rezultojnë në shumën 3.278.743 lekë.
 - d. Për rrjedhojë, rezultojnë të ketë mospërputhje midis të ardhurave *neto* të deklaruara si të fituara në vitin 2009 dhe të atyre të dokumentuara nga ky biznes. Gjithashtu konstatohet një diferencë e konsiderueshme midis të ardhurave *bruto* (të xhiros vjetore), sipas faturave të paraqitura nga subjekti dhe shumave të deklaruara si qarkullim vjetor, mbi të cilat janë paguar detyrimet tatimore.
- ii. Për vitin **2010**, nga analiza financiare e të ardhurave dhe e shpenzimeve të kryera ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.
 - a. Të ardhurat nga pagat dhe nga biznesi i bashkëshortit të subjektit për vitin 2010 janë deklaruar në vlerën 1.515.480 lekë, ndërkohë që të ardhurat *neto* të dokumentuara rezultojnë në vlerën 1.197.211 lekë.
 - b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2010, lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit, janë deklaruar të ardhura në vlerën 600.000 lekë. Fitimi, sipas dokumenteve ka rezultuar në vlerën 311.007 lekë, ndërsa të ardhurat *bruto*, sipas dokumenteve të biznesit, kanë rezultuar në vlerën 1.668.400 lekë.
 - c. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, nga subjekti janë vënë në dispozicion fatura tatimore shitjeje, të cilat rezultojnë në vlerën 2.492.000 lekë.
 - d. Nga sa më lart, edhe në vitin 2010 rezultojnë mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara si të fituara lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit dhe atyre të

dokumentuara, dhe po ashtu, faturimi i këtij biznesi, sipas dokumenteve të paraqitura nga subjekti, rezulton shumë më i lartë nga ato që janë deklaruar për efekt të tatimit.

- iii. Për vitin **2011**, nga analiza financiare e të ardhurave dhe e shpenzimeve të kryera ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.
 - a. Të ardhurat nga pagat dhe nga biznesi i bashkëshortit të subjektit për vitin 2011 janë deklaruar në vlerën 3.002.980 lekë ndërkohë që të ardhurat e dokumentuara rezultojnë vetëm 1.387.252 lekë.
 - b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2011, lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit, janë deklaruar të ardhura *neto* në vlerën 1.800.000 lekë, ndërsa fitimi sipas dokumenteve ka rezultuar në vlerën 439.056 lekë, kurse të ardhurat *bruto*, sipas dokumenteve të biznesit, kanë qenë në vlerën 1.856.000 lekë.
 - c. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, nga subjekti janë vënë në dispozicion fatura tatimore shitjeje, të cilat rezultojnë në vlerën 3.114.370 lekë.
 - d. Si konkluzion, edhe për vitin 2011 ka mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara si të fituara dhe atyre të dokumentuara. Gjithashtu, totali i xhiros vjetore të faturuar – sipas faturave të paraqitura nga subjekti, sikurse edhe për vitet 2009 dhe 2010 – rezulton të ketë qenë shumë më tepër se shumat e deklaruara në institucionin tatimor. Për rrjedhojë, pagesa e tatimeve nga biznesi i bashkëshortit të subjektit nuk i ka mbuluar të gjitha të ardhurat e gjeneruara prej tij përgjatë këtyre viteve, duke e bërë të paligjshme diferencën e të ardhurave, në kuptimin e ligjit nr. 84/2016. Mospagesa e plotë e tatimeve, për të gjitha të ardhurat e fituara nga një biznes, veç moskonsiderimit si burim i ligjshëm financiar i shumave të patatuara, mund të ndikojë negativisht në etikën e subjektit.
- iv. Për vitin **2012**, nga analiza financiare e të ardhurave dhe e shpenzimeve të kryera, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.
 - a. Të ardhura nga pagat dhe nga biznesi i bashkëshortit të subjektit për vitin 2012 janë deklaruar në vlerën 2.355.450 lekë, ndërkohë që të ardhurat e dokumentuara janë në vlerën 1.255.605 lekë.
 - b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2012, lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit, janë deklaruar të ardhura në vlerën 1.426.000 lekë, ndërsa fitimi sipas dokumenteve ka rezultuar në vlerën 326.408 lekë, ndërsa të ardhurat *bruto*, sipas dokumenteve të biznesit, kanë qenë në vlerën 1.548.918 lekë.
 - c. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, nga subjekti janë vënë në dispozicion fatura tatimore shitjeje, të cilat rezultojnë në vlerën 1.581.238 lekë, për rrjedhojë, ka mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara si të fituara dhe atyre të dokumentuara.
- v. Për vitin **2013**, nga analiza financiare e të ardhurave dhe e shpenzimeve të kryera, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.

- a. Të ardhurat nga pagat dhe nga biznesi i bashkëshortit të subjektit për vitin 2013 janë deklaruar në vlerën 2.390.024 lekë, ndërkohë që të ardhurat e dokumentuara janë vetëm 1.100.024 lekë.
 - b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2013, lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit, janë deklaruar të ardhura në vlerën 1.540.000 lekë, ndërsa fitimi sipas dokumenteve ka rezultuar në vlerën 250.000 lekë, kurse të ardhurat *bruto*, sipas dokumenteve të biznesit, kanë qenë në vlerën 1.567.966 lekë.
 - c. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, nga subjekti janë vënë në dispozicion fatura tatimore shitjeje, të cilat rezultojnë në vlerën 1.604.927 lekë.
 - d. Për rrjedhojë, ka mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara në ILDKPKI si të fituara dhe atyre të dokumentuara.
- vi. Për vitin **2014**, nga analiza financiare e të ardhurave dhe e shpenzimeve të kryera ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.
- a. Të ardhurat nga pagat dhe nga biznesi i bashkëshortit të subjektit për vitin 2014 janë deklaruar 1.764.801 lekë ndërkohë që të ardhurat e dokumentuara janë 1.400.380 lekë;
 - b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2014, lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit, janë deklaruar të ardhura në vlerën 700.000 lekë, ndërsa fitimi sipas dokumenteve ka rezultuar në vlerën 308.400 lekë kurse të ardhurat *bruto*, sipas dokumenteve të biznesit, kanë qenë në vlerën 700.000 lekë.
 - c. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, nga subjekti janë vënë në dispozicion fatura tatimore shitjeje, të cilat rezultojnë në vlerën 708.604 lekë.
 - d. Për rrjedhojë, ka mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara si të fituara dhe atyre të dokumentuara, si më lart.
- vii. Për vitin **2015**, nga analiza financiare e të ardhurave dhe e shpenzimeve të kryera, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.
- a. Të ardhura nga pagat dhe nga biznesi i bashkëshortit të subjektit për vitin 2015 janë deklaruar në vlerën 1.367.468 lekë, ndërkohë që të ardhurat e dokumentuara janë në vlerën 1.340.951 lekë.
 - b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2015, lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit, janë deklaruar të ardhura në vlerën 249.342 lekë, ndërsa fitimi sipas dokumenteve ka rezultuar në vlerën 224.342 lekë, kurse të ardhurat *bruto*, sipas dokumenteve të biznesit, kanë qenë në vlerën 777.634 lekë.
 - c. Pas njohjes me rezultatet e hetimit, nga subjekti janë vënë në dispozicion fatura tatimore shitjeje, të cilat rezultojnë në vlerën 785.634 lekë.
 - d. Për rrjedhojë, edhe në këtë vit, ka mospërputhje midis të ardhurave të deklaruara si të fituara dhe atyre të dokumentuara.
- viii. Për vitin **2016**, nga analiza financiare e të ardhurave dhe e shpenzimeve të kryera, ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.

- a. Ndërkohë që edhe të ardhurat nga pagat dhe biznesi i bashkëshortit të subjektit për vitin 2016 janë deklaruar në vlerën 1.175.642 lekë, në të njëjtën vlerë me ato të dokumentuara.
- b. Në deklaratën periodike vjetore për vitin 2016, lidhur me biznesin e bashkëshortit të subjektit, janë deklaruar të ardhura *neto* në vlerën 127.231 lekë, ndërkohë që edhe fitimi sipas dokumenteve ka rezultuar në të njëjtën shumë, pra, në vlerën 127.231 lekë.
- c. Për rrjedhojë në këtë vit ka përputhje të shumave të deklaruara me ato të dokumentuara.

2.1 Vlerësimi i trupit gjykues

- i. Në vijim të analizës së mësipërme, lidhur me burimet financiare dhe me deklaratimet ndër vite të subjektit të rivlerësimit, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, dhe familja e saj, ka pasur të ardhura të mjaftueshme, nga burime të ligjshme, për të përballuar investimet dhe shpenzimet e kryera dhe kursimet e realizuara.
- ii. Gjithashtu, trupi gjykues çmon se subjekti dhe personi i lidhur me të, kanë kryer deklaratime të pamjaftueshme vjetore për periudhën 2009 – 2015, duke deklaruar të ardhura *neto* më të larta nga sa ka rezultuar nga dokumentacioni provues i administruar nga Komisioni.
- iii. Komisioni vlerëson se pasi janë analizuar dhe përlllogaritur të gjitha faturat e paraqitura nga vetë subjekti – për të provuar xhiron e biznesit të bashkëshortit të vet – ka rezultuar se deklaratimet e të ardhurave, të kryera pranë organeve tatimore nga ky biznes, nuk përkojnë me ato reale, pasi, së paku në tre vjet (2009 – 2011), nuk janë deklaruar, për efekt të tatimeve mbi 3,6 milionë lekë. Ky konkluzion bazohet në faktin që totali i shumave të deklaruara në këto tre vjet, si qarkullim vjetor, rezulton në vlerën 5.224.400 lekë, ndërkohë që shumatoria e faturave të paraqitura nga subjekti, si xhiro vjetore e këtyre viteve, arrin në një total prej 8.914.000 lekësh, pra, me një diferencë të padeklaruar dhe të patatuar prej 3.689.600 lekësh.
- iv. Trupi gjykues çmon se pamjaftueshmëria e dyfishtë dhe e përsëritur e deklaratimeve të të ardhurave nga biznesi i bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, trajtuar më lart, së bashku me pamjaftueshmëritë e deklaratimeve të disa pasurive të vetë subjektit të deklaruara në deklaratën “Vetting” dhe ndër vite, na çon në aplikimin e pikës 3, të nenit 61, të ligjit 84/2016.

B. KONTROLLI I FIGURËS

- i. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit. Për këtë qëllim, në datën 2.11.2017 është përcjellë në Komision një raport për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39, të ligjit 84/2016, – i përpiluar pa përgjigjen e një prej autoriteteve verifikuese – ku fillimisht ishte konstatuar “Përshtatshmëria e subjektit të rivlerësimit për vazhdimin e detyrës”.
- ii. Më pas, në datën 20.7.2018, DSIK-ja përcjell në Komision një raport të përditësuar, të deklasifikuar² pjesërisht – në të cilin konkludohet: “*Nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritet verifikuese, ndryshon konstatimi fillestar, nga përshtatshmëri, në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi*”.

² Vendimi nr. ***, datë 20.7.2018, i KDZH-së.

(Nushaj), pasi ka të dhëna se subjekti i rivlerësimit ka pasur kontakte të papërshtatshme, si dhe ka qenë e implikuar në veprimtari korruptive të funksionit të drejtësisë, për një periudhë relativisht të gjatë kohe dhe në më shumë se në një rast, si dhe ndikim dhe favorizim të paligjshëm të të pandehurve, në papajtueshmëri të plotë me detyrën e saj”.

- iii. Komisioni i njoftoi subjektin të rivlerësimit, me anë të rezultateve të hetimit kryesisht, konstatimin e rishikuar të DSIK-së në lidhje me papërshtatshmërinë e tij për vazhdimin e detyrës. Subjekti i rivlerësimit në prapësimet e tij dhe gjatë seancës dëgjimore shpjegoi se konkluzionet e DSIK-së nuk qëndronin, pasi ajo nuk ishte përfshirë ndonjëherë në veprimtari korruptive dhe nuk kishte pasur ndonjë kontakte të papërshtatshme.
- iv. Nga hetimi administrativ dhe nga rivlerësimi i kryer nga Komisioni, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 38, të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, bazuar në provat dhe dokumentet që disponon, si dhe në vlerësimin e çështjes në tërësi në lidhje me kriterin e figurës, arrin në përfundimin se në raportin e dërguar nga DSIK-ja vlerësimi i kryer nuk përmban rrethanat që merren parasysh në konstatimin se ekziston një kontakt i papërshtatshëm me një person të përfshirë në krimin e organizuar, dhe se informacionet dhe dyshimet e ngritura mbi rrethana të tjera, që lidhen me integritetin, nuk janë të bazuara mjaftueshëm për të konkluduar për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit.

Në këto kushte, Komisioni, në lidhje me kriterin e kontrollit të figurës, nuk krijon bindjen për papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit për vijueshmërinë e funksionit të tij, dhe se konstatimet e mësipërme nuk mund të konsiderohen si shkak për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit sipas pikës 2, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, por ato mund të merren në konsideratë në vlerësimin tërësor të rivlerësimit.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Komisioni ka kryer rivlerësimin e aftësive profesionale në përputhje me nenin E të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

Rivlerësimi i aftësive profesionale është mbështetur në:

- a. raportin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë (në vijim “KLP”);
- b. informacione të tjera të marra gjatë hetimit administrative nga organet ligjzbatuese;
- c. kriteret e vlerësimit të parashikuara në legjislacionin mbi statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë; dhe
- d. denoncimet nga publiku.

C/1 RAPORTI I VLERËSIMIT TË AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

- i. Komisioni ka administruar Raportin e përpiluar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i cili ka analizuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit. Fillimisht, raporti në fjalë është përcjellë sipas praktikës së komunikimit midis KLP-së dhe Komisionit në rrugë elektronike, dhe më pas edhe fizikisht. Formulimi i rezultateve të hetimit përpara se të mbërrinte fizikisht ky raport nuk rezulton të ketë cenuar të drejtat e subjektit apo të ketë pasqyruar ndonjë pasojë për të.

- ii. Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin:
 - a. e formularit të vetëdeklarimit, të tre dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;
 - b. e pesë dosje penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
 - c. e të dhënave nga burimet arkivore të prokurorisë/ve.
- iii. Të dhënat e rezultuara nga dokumentet e sipërpërmendura i janë referuar kriterëve të vlerësimit në lidhje me: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; (d) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.
- iv. Nga raporti i administruar nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, veç të tjerash, ka rezultuar se nga të dhënat arkivore pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Prokurorinë e Përgjithshme për prokuroren subjekt vlerësimi, znj. Alketa Nushi, rezulton se nuk ka masa disiplinore, edhe pse nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Sektorin e Protokollit dhe Arkivit në Prokurorinë e Përgjithshme rezulton se janë paraqitur dy ankesa:
 - a. **Praktika nr. *** e vitit 2018 nga shtetasja M. U.**, në të cilin kallëzuesja ankohet për pushimin e çështjes nga subjekti, meqenëse shtetasi i akuzuar ka të vëllanë prokuror dhe mbrohet nga kryeprokurorja e rrethit, e cila është e akomoduar në hotelin e palës së akuzuar. Prokuroria e Përgjithshme, duke konsideruar rrethanat e çështjes, e ka përcjellë këtë dosje në Prokurorinë e Tropojës për kompetencë hetimore, dhe i ka sugjeruar kallëzueses që pretendimet lidhur me hetimin e çështjes t’ia drejtojë kësaj të fundit si dhe gjykatës përkatëse, që mbi bazë ankimi kanë të drejtë të kontrollojnë vendimin e marrë nga prokurori.
 - b. **Praktika nr. *** e vitit 2018 nga shtetasja S. S.**, i është drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme me ankesën nr. 705, datë 26.3.2018, e cila është administruar në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun. Në ankesën e saj kjo shtetase ka shpjeguar se është bashkëshortja e një personi të vrarë dhe për këtë rast nuk po bëhet drejtësi, pasi korrupsioni është i paparë, me në krye A. Ç. dhe dy prokurorët Alketa Nushi dhe H. V. Prokuroria e Përgjithshme, ankesën e saj e ka përcjellë për kompetencë dhe zgjidhje ligjore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, duke u njoftuar edhe ankuesja.
- v. Gjithashtu, KLP-ja shprehet se për subjektin e rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, janë administruar disa informacione të rezervuara të përcjella për vlerësim nga Prokuroria e Përgjithshme, në lidhje me disa dosje konkrete, të cilat, sipas informacioneve kishin lidhje me veprimtarinë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi.
- vi. Lidhur me vlerësimin profesional të kryer nga Prokurori i Përgjithshëm i Republikës së Shqipërisë, ka rezultuar se subjekti Alketa Nushi është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale të treguara për vitet 2014, 2015 dhe 2016.
- vii. Në përfundim, Këshilli i Lartë i Prokurorisë nga analiza e tri grupeve të burimeve të informacionit: (i) formularit të vetëvlerësimit dhe dokumentacionit të paraqitur nga vetë subjekti; (ii) tri dokumentet ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve të vëzhguara të përzgjedhura me short³; dhe (iv) të dhënat nga burimet arkivore në

³ Ndër të cilat, në dosjen nr. *** të shortuar, janë konstatuar problematika dhe janë ngritur dyshime mbi veprimtarinë hetimore të subjektit edhe nga vlerësimi i KLP-së;

Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ka konkluduar se nuk janë konstatuar mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi.

C/2 RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE NGA KOMISIONI

Referuar disa informacioneve të marra nga Komisioni, nga organet ligjzbatuese, dhe denoncimeve nga publiku, sipas parashikimeve të nenit 53, të ligjit nr. 84/2016, janë administruar disa dosje hetimore dhe gjyqësore për të vlerësuar aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, sipas nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, dhe konkretisht:

1. Dosja penale që i përket procedimit penal nr. * të vitit 1997**

Komisioni ka administruar dhe studiuar dosjen e plotë të këtij procedimi penal, për të cilën nuk është konstatuar asnjë veprimtari hetimore e kryer nga subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi.

2. Dosja penale që i përket procedimit penal nr. * të vitit 2017**

Kjo dosje penale, e regjistruar kundër shtetasve A. S., A. A. (*alias* A. D.), K. S., A. (Ar.) K., është hetuar nga subjekti i rivlerësimit dhe, nga shqyrtimi dhe studimi i saj, ka rezultuar se:

- i. Në datën 10.9.2017, subjekti i rivlerësimit i ka kërkuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat aplikimin e masës së sigurisë “*detyrim paraqitjeje dhe garanci pasurore (200.000 lekë)*” për të pandehurin A. S., i cili rezultonte i akuzuar për tri vepra penale shumë më të rënda se akuza e vetme që ishte ngritur ndaj shtetasit A. A. Por, edhe pse shtetasi A. S. ishte akuzuar vetëm për moskallëzim krimi – i përfshirë në të njëjtën ngjarje dhe në të njëjtin procedim penal – subjekti i rivlerësimit për të kishte kërkuar masë sigurie “*arrest me burg*”.
- ii. Fakti që pas lirimimit nga burgu shtetasi A. A. është larguar pa lënë gjurmë – sikurse është deklaruar mosgjeteja e tij me vendimin datë 3.9.2018 të Prokurorisë Mat– evidenton ekzistencën e rrezikut të largimit të tij për t’iu shmangur drejtësisë. Ky rrezik më herët ishte konsideruar prezent edhe nga subjekti i rivlerësimit, por ajo vetëm pas 9 ditësh, në datën 10.9.2017, ka ndryshuar qëndrim e saj - duke mos e konsideruar më këtë rrethanë, një shkak për mosndryshimin e masës arrest me burg, dhe duke dhënë pëlqimin e saj për daljen nga burgu të shtetasit, i cili më pas ka humbur gjurmët dhe i është shmangur drejtësisë.
- iii. Gjithashtu, nga dosja në fjalë ka rezultuar se me vendimin e datës 4 (apo 8⁴).12.2017, subjekti i rivlerësimit, me cilësinë e prokurores së çështjes, pasi ka studiuar fashikullin e procedimit penal nr. *** në ngarkim të shtetasit K. S., për veprën penale “*plagosje e lehtë me dashje*” në dëm të shtetasit A. A. (*alias* A. D.), dhe pasi ka dëgjuar dëshmitarët, ka vendosur pushimin e hetimit për këtë vepër penale.
- iv. Në konkludim të hetimit, subjekti i rivlerësimit në datën 8.12.2017 kërkon dërgimin e dosjes së procedimit penal nr. *** për gjykim duke konsideruar të pandehur vetëm dy nga të dyshuarit:
 1. shtetasin A. S., me akuzën “*prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municionit*” dhe “*prodhim dhe mbajtje të lëndëve narkotike*”;
 2. shtetasin A. A. (*alias* A. D.), i akuzuar për veprat penale “*moskallëzim krimi*” dhe “*prishje të qetësisë publike*” të kryer në bashkëpunim⁵.

⁴ Vendimi ka mospërputhje datash midis asaj në fillim të aktit, që është 4.12.2017, ndërsa në mbyllje të tij data është 8.12.2017.

⁵ Nuk arrihet të kuptohet se me cilin person është kryer ky bashkëpunim, nga momenti që nuk rezulton asnjë shtetas i akuzuar për të njëjtën vepër.

- v. Më pas, subjekti ka nxjerrë edhe një urdhër penal – që në vijim miratohet nga gjykata – me të cilin kërkon dënimin e pothuajse të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në përballjen/ngjarjen objekt hetimi, me 50.000 lekë gjobë, për prishje të qetësisë publike.
- vi. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2018, ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. ***, pranë Prokurorisë Mat për vazhdimin e hetimeve.
- vii. Vendimi i mësipërm i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat është ankimuar në datën 15.5.2018 dhe është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë.
- viii. Nga sa më lart, Komisioni konstaton se ka disa mospërputhje të rëndësishme në lidhje me formulimin e akuzave të përcjella në gjykatë, si më poshtë:
 - a. arma e gjetur në posedim të shtetasit A. S. ishte material plasës (kapsolla detonatori) dhe jo armë zjarri. Mbajtja e armëve plasëse dënohet më shumë se shkelja për armëmbajtje pa leje. Pra, rezulton të ketë pasur së paku një anomali në formulimin e klasifikimit dhe cilësimit të veprës penale konkrete, e cila ka passjellë një favorizim të pandehurit;
 - b. nuk rezulton të jetë akuzuar askush për plagosje me dashje me armë zjarri dhe as për armëmbajtje pa leje, ndërkohë që është e provuar – nga vetë dokumentacioni në dosjen në fjalë – se në ngjarjen në fjalë ka qenë të paktën një person i armatosur dhe se dikush ka shtirë me armë, të paktën dy fishekë, si dhe që një person ka ngelur i plagosur.
- ix. Gjithashtu, konstatohet një mangësi në kryerjen e veprimeve hetimore, jo vetëm në lidhje me marrjen në pyetje në mënyrë efikase të personave që i njohin faktet, por nuk rezulton që të jenë këqyruar/administruar, kërkuar regjistrimet filmike, publike, të lokaleve ose bizneseve, në afërsi të vendit të ngjarjes, duke konsideruar se faktet kanë ndodhur në qendër të qytetit, përpara një lokali bar-kafe. Gjithashtu, nuk ka pasur ballafaqime apo akuza për deklarime të rreme përpara prokurorit dhe OPGJ-së, edhe pse disa persona të pyetur kanë ndryshuar versionin e pohimeve të tyre totalisht dhe në mënyrë të dyshimtë.
- x. Së fundmi, nënvizohet fakti se lidhur me këtë procedim ka: shumë mangësi hetimore; mungesë të arsyeve për pushim hetimi për disa të akuzuar; kërkesë të munguar për gjykimin e të akuzuarve të tjerë dhe formulim të pasaktë ose të paplotë të akuzave të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit që janë konstatuar, evidentuar dhe argumentuar edhe nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me vendimin nr. ***, datë 23.3.2018, e cila ka vendosur kthimin e akteve të procedimit penal nr. *** pranë Prokurorisë Mat, për vazhdimin e hetimeve, dhe ky vendim është lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë.
- xi. Lidhur me sa më lart, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e rezultateve të hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, në mënyrë të përmbledhur, ka shpjeguar se:
 - a. ky procedim është jashtë afatit të rivlerësimit (8.10.2013 – 8.10.2016) dhe nuk mund të analizohet nga Komisioni për rivlerësimin profesional;
 - b. vlerësimi i masave të sigurisë është bërë duke pasur parasysh cilësitë personale të autorëve dhe të veprave penale të dyshuara;
 - c. zbutja e masës së sigurisë ndaj shtetasit A. A. është bërë edhe në funksion të marrëveshjes së pajtimit mes palëve, pasi kjo masë kishte efekt parandalues;
 - d. për sa i përket mosakuzimit për plagosje, nuk është bërë pasi nuk është provuar kush ishte autori i kësaj vepre penale të konsumuar;

- e. ndërsa, konkluzionet e vendimit nr. ***, datë 23.3.2018, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat për kthimin e akteve në prokurori dhe plotësimin e hetimeve, nuk duhet të mbahen në konsideratë nga Komisioni, pasi ato kanë aspekt procedural dhe nuk lidhen me mungesa të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
 - f. gjithashtu, subjekti ka paraqitur një sërë aktesh të këtij procedimi.
- xii. Komisioni, **bazuar në provat dhe dokumentet që disponon nga hetimi administrativ, shpjegimet dhe provat e subjektit të rivlerësimit në prapësimet e rezultateve të hetimit dhe gjatë seancës dëgjimore, si dhe vlerësimin e kësaj çështjeje në tërësi, arrin në përfundimin** se hetimet e këtij procedimi dhe përfundimi i tyre, me formulimin e akuzave të sipërpërkruara, nxjerr në pah disa mangësi në aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit, pasi veprimet dhe mosveprimet hetimore kanë çuar në kryerjen e hetimeve të cunguara dhe në konkluzione të deformatuara, me cilësim jo korrekt të veprës penale, së paku në një rast të formuluar jo në përputhje me faktet e përshkruara në aktet e dosjes në fjalë – siç është evidentuar edhe nga vendimi nr. ***, datë 23.3.2018, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat, për kthimin pranë Prokurorisë Mat të akteve të procedimit penal nr. *** dhe plotësimin e hetimeve – vendim ky i lënë në fuqi edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë.
- xiii. Lidhur me afatin dhe mundësinë e rivlerësimit të dosjeve profesionale, Komisioni, qartëson se periudha kohore për vlerësim, 8.10.2013 – 8.10.2016, e parashikuar nga pika 3, e nenit 41, të ligjit nr. 84/2016, i referohet dhe është parashikuar vetëm për sa i përket përzgjedhjes në mënyrë rastësore të pesë dosjeve/akteve që vlerësohen nga organet ndihmëse. Ndërsa, rivlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni, nisur nga informacioni që ai disponon – sipas parashikimit të pikës 4, të nenit të sipërcituar, dhe në kombinim me pikën 4, të nenit 43, të ligjit nr. 84/2016 – mund të shtrihet nga data 1 janar 2006 e në vijim, pra, edhe mbi procedime/çështje të viteve dhe muajve të mëpasshëm (referuar datës 8.10.2016), me të vetmin kusht që subjekti i rivlerësimit ose organi ku ai ka kryer funksionin, të jetë shprehur përfundimisht mbi çështjen/dosjen në fjalë.

3. Dosja penale që i përket procedimit penal nr. *** (bashkuar me nr. ***)

Pas studimit të dosjes në fjalë dhe akteve të lidhura të administruara nga Komisioni, ka rezultuar se:

- i. Në datën 2.4.2017, Prokuroria Mat ka regjistruar procedimin penal nr. ***, ndaj shtetasve: A. Gj., me akuzën “*prodhim/mbajtje e lëndëve narkotike*”, “*prodhim dhe mbajtje pa leje e armëve dhe të municionit*”; dhe S. D., vetëm për akuzën “*mbajtje e municionit*”.
- ii. Me vendimin nr. ***, datë 15.3.2018, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat ka vendosur: kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat për plotësim të hetimeve, pasi ato janë konsideruar të paplota; si dhe është konstatuar pavlefshmëria relative e procesverbalit të datës 2.4.2017, për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale, të kryer nga OPGJ-ja, në shkelje të autorizimit të dhënë nga prokurori kompetent. Me këtë vendim është urdhëruar përsëritja e pyetjes së dy shtetasve.
- iii. Gjithashtu, si akt i pavlefshëm është vlerësuar nga gjykata edhe një procesverbal i datës 29.6.2017, për marrjen e të dhënave dhe pyetjen mbi informacione dhe kontakte me persona nën hetim nga personi që ka dijeni për veprën penale, të shtetas Sh. D. Rezulton se ky procesverbal është mbajtur dhe nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe pa prezencën e OPGJ-së.

- iv. Sërish, në datën 24.4.2018, me një tjetër vendim të ndërmjetëm, nr. ***, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ka vlerësuar edhe një herë se hetimet në fjalë rezultonin të paplota, si dhe ka theksuar konstatimin se: “ ... *moskryerja e veprimeve hetimore të urdhëruara nga gjykata apo/dhe e ndonjë veprimi tjetër hetimor, që mund të lindte si eventualitet i paskryerjes së veprimeve hetimore të mëparshme/të urdhëruara, përbën rast të anashkalimit të urdhërimeve që burojnë nga një vendim gjyqësor...* ”.
- v. Për rrjedhojë, në vijim të konstatimeve të sipërcituara, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, vendos sërish kthimin e akteve pranë prokurorisë për plotësimin e hetimeve, pasi ato konsiderohen të paplota, veç të tjerash, duke urdhëruar pyetjen e tre personave, dhe për këtë cakton një afat 15 ditor.
- vi. Duket se nga analiza e veprimtarive profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar disa mangësi profesionale që lidhen kryesisht me moskryerjen e hetimeve të plota dhe me redaktimin e akteve në mënyrë jo komfom parashikimeve procedurale, pasi mosrespektimi i tyre ka pasjellë pavlefshmërinë e akteve në vetvete dhe për pasojë edhe zvarritjen/shtyrjen e hetimeve në fjalë, për shkak të përsëritjes të disa veprimeve hetimore.
- vii. Subjekti i rivlerësimit, edhe në lidhje me këtë procedim ka ngritur pretendimet se ai është jashtë periudhës së rivlerësimit, dhe për rrjedhojë, nuk duhet të merret në konsideratë për rivlerësimin e aftësive profesionale të saj. Lidhur me këtë pikë, Komisioni risjell në vëmendje sa u argumentua më sipër – në analizimin e dosjes nr. ***, paragrafi i fundit (xiii).
- viii. Gjithashtu, subjekti ka vënë në pah se përgjatë fazës hetimore ajo është larguar për një periudhë jashtë vendit, dhe për këtë arsye ishte zëvendësuar nga një koleg, për të rimarrë në dorë hetimet pas kthimit të saj në punë.
- ix. Sipas subjektit, vendimet e gjykatës për kthimin e akteve në prokurori, për të rikryer hetimet, pasi është konstatuar hetimi i paplotë, është një aspekt procedural dhe nuk mund të konsiderohet nga Komisioni si një mangësi profesionale.
- x. Lidhur me konstatimin e gjykatës mbi hetimet e mbyllura më 20.1.2018, subjekti sqaron se në atë datë nuk ka qenë me detyrë në atë prokurori, pasi në datën 9.1.2018 është transferuar me funksion në Kukës, dhe paraqet dokumentacion për sa ka shpjeguar.
- xi. Komisioni vëren se edhe pse për një periudhë të caktuar subjekti nuk ka pasur këtë dosje në hetim, ajo ka kryer pothuajse të gjitha veprimet hetimore – pjesë të të cilave janë konsideruar nga gjykata si jo të rregullta. Gjithashtu, mangësitë e konstatuara për dy herë rresht nga gjykata, lidhur me hetimet e paplota, dhe me mospërmbyshjen e urdhrave të dhëna nga gjykata, sigurisht që pasqyrojnë edhe mangësi profesionale të personave për veprimet apo mosveprimet e tyre të përsëritura – me përjashtim të rastit hipotetik, nëse dhe kur mund të provohej se ato veprime/mosveprime/pasoja kanë qenë të vetëdijshme, të qëllimshme apo për neglizhencë të tolerueshme. Për rrjedhojë, në rastin konkret, për sa kohë veprimet apo mosveprimet e subjektit kanë rezultuar jo në përputhje me dispozitat procedurale ligjore, apo me urdhrin e gjykatës, Komisioni çmon se ato përbëjnë, së paku, mangësi profesionale.

4. Dosja penale që i përket procedimit penal nr. ***

Lidhur me procedimin nr. *** në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, të regjistruar kundër shtetasit F. N., të hetuar nga prokurorja Alketa Nushi

Komisioni, pasi ka administruar dhe studiuar dosjet përkatëse, ka konstatuar se:

- i. Në datën 19.12.2012, subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, ka vendosur pushimin e çështjes ndaj shtetasve F. N. dhe E. N., të dyshuar për veprën penale *“vrasje në rrethana të tjera cilësuese, kryer në bashkëpunim, mbetur në tentativë”*.
- ii. Ndërsa, në datën 12.2.2013 - pasi kishte kryer veprimet hetimore të vlerësuara prej saj si të nevojshme dhe të mjaftueshme - subjekti ka mbyllur fazën hetimore dhe ka vendosur pushimin e çështjes ndaj shtetasit F. N., të dyshuar për veprën penale *“vrasje në rrethana të tjera cilësuese, mbetur në tentativë”*.
- iii. Në arsyetimin e vendimit të pushimit, subjekti shprehet se është provuar se i dyshuari F. N. është autori i dy plagosjeve si më lart, por ato janë shkaktuar nga pakujdesia, dhe meqenëse vepra e plagosjes së lehtë nga pakujdesia, e parashikuar nga neni 92 i Kodit Penal nuk mund të ndiqet kryesisht nga prokuroria, çështja në fjalë duhet të pushohet, në bazë të nenit 328/f të Kodit të Procedurës Penale.
- iv. Në datën 15.2.2013, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, me kërkesën e të dyshuarit F. N. dhe me dakordsinë e prokurores Alketa Nushi, ka zëvendësuar masën e sigurisë personale, nga arrest me burg, në arrest në shtëpi.
- v. Në datën 18.3.2013, prokurori A. M., në cilësinë e drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, ka shfuqizuar vendimin e pushimit të firmosur nga subjekti më 12.2.2013, pasi ai ka konstatuar një sërë mangësish lidhur me veprimet dhe mosveprimet hetimore, si dhe në (mos)argumentimin e kualifikimit të ndryshimit të veprës penale, në vendimin e pushimit, në krahasim me akuzën e përshkruar në momentin e regjistrimit të çështjes në fjalë.
- vi. Për më tepër, në datën 27.3.2013, drejtuesi ka urdhëruar zëvendësimin e prokurores (subjektit), si dhe të OPGJ-së (F.D.), pasi e ka vlerësuar të domosdoshëm këtë ndryshim për të mundësuar vazhdimin dhe përfundimin e hetimeve të çështjes në fjalë.
- vii. Në datën 8.5.2013, znj. Alketa Nushi, ka paraqitur ankim, ndaj vendimit të zëvendësimit të saj, tek Prokurori i Përgjithshëm.
- viii. Në datën 11.6.2013, Prokurori i Përgjithshëm, pasi ka shqyrtuar ankimin e subjektit, ka vendosur mospranimin e tij, duke konsideruar të bazuar vendimin e zëvendësimit të saj.
- ix. Subjekti i rivlerësimit, lidhur me këtë dosje, ka paraqitur shpjegimet e veta, duke u shprehur se veprimet dhe vendimet e saj ishin të drejta dhe se ky fakt ishte konfirmuar edhe nga Gjykata e Apelit Tiranë, e cila kishte prishur vendimin nr. ***, të datës 16.4.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Mat.
- x. Nga sa më lart, Komisioni çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime bindëse lidhur me mangësitë e konstatuara dhe të paraqitura nëpërmjet rezultateve të hetimit, si nga Drejtuesi i Prokurorisë edhe nga Prokurori i Përgjithshëm, në hetimet e saj lidhur me këtë çështje. Përtej llojit dhe shkaqeve të vendimit që mund të japë një gjykatë, mangësitë, veprimet apo mosveprimet në këtë hetim janë analizuar, konstatuar dhe konfirmuar nga të gjitha nivelet (hierarkike) të institucionit të prokurorisë, pasi ata kanë njohur edhe shpjegimet, prapësimet dhe pretendimet e subjektit lidhur me arsyet e veprimtarisë hetimore nga ana e saj, dhe për rrjedhojë ato nuk mund të anashkalohen.
- xi. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se: (a) *kualifikimi i veprës penale i bërë në mënyrë jo korrekte, nga ana e subjekti, lidhur me plagosjet në fjalë – pasi njëra prej të cilave ka shkaktuar pasoja me paaftësi mbi 9 ditë; (b) zbutja e masës së sigurisë me pëlqimin e*

subjektit, më 15.2.2013, nuk është bazuar në ndryshime konkrete të rrethanave;(c) moskryerja e hetimeve të plota dhe të gjithanshme;(ç) moskonkludimin e hetimeve edhe me akuzën plagosjes me cilësimin e duhur juridik, pasi personi nën hetim, ishte identifikuar nga vetë subjekti si autori i veprës penale, por ajo është kualifikuar në mënyrë jo të saktë dhe në mospërputhje me faktet dhe rrethanat, përbëjnë një sërë mangësish profesionale të subjektit, që kanë ndikuar në veprimet hetimore në fjalë – siç janë specifikuar edhe nga drejtuesi i prokurorisë në vendimin e tij të shfuqizimit të pushimit të hetimit, që e kanë bërë të domosdoshme zëvendësimin e subjektit të rivlerësimit me një tjetër prokuror, për të ndjekur këtë dosje, dhe konfirmuar edhe nga Prokurori i Përgjithshëm.

5. Dosja penale që i përket procedimit penal nr. ***

- i. Dosja që i përket procedimit penal nr. ***, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Mat, e regjistruar kundër shtetasit S. Xh., në datën 13.1.2015, nga subjekti për veprën penale “*vjedhje duke shpërdoruar detyrën*”

Nga studimi i kësaj dosjeje ka rezultuar se:

 - a. Pasi në datën 19.2.2015, i akuzuari ishte marrë si i pandehur, në datën 23.2.2015 subjekti ka deklaruar mosgjatjen e të pandehurit S. Xh., pasi nga sistemi TIMS rezultonte se ai kishte dalë jashtë territorit të Shqipërisë;
 - b. Po në datën 23.2.2015, prokurorja Alketa Nushi ka kërkuar gjykimin e procedimit penal në fjalë, kundër të pandehurit S. Xh., për veprën penale “*vjedhje duke shpërdoruar detyrën*”;
 - c. Në datën 4.3.2015, drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Mat, prokurori A. M., ka vendosur shfuqizimin e vendimit të subjektit të datës 23.2.2015, për dërgimin e çështjes për gjykim, me arsyetimin se hetimet rezultojnë të paplota, pasi duhej të administroheshin një sërë dokumentesh dhe duhej të dëgjoheshin disa persona të tjerë, si dhe për faktin se OPGJ-ja kishte kryer veprime, përtej kompetencës së tij, pa qenë i urdhëruar apo i deleguar nga prokurorja e çështjes.
- ii. Gjithashtu, drejtuesi kishte konstatuar mungesën e lëshimit të një urdhër-kërkimi, pasi ishte deklaruar mosgjatja e të pandehurit, pa e njoftuar për thirrjen për t’u paraqitur, si dhe duhej të ishte kërkuar një masë sigurie ndaj tij, duke pasur parasysh rëndësinë e veprës penale dhe dënimin e parashikuar për të (deri në 10 vjet burg).
- iii. Për rrjedhojë, drejtuesi i prokurorisë kishte urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore të munguara nga subjekti, duke caktuar një afat deri në datën 25.3.2015.
- iv. Në datën 9.3.2015, subjekti i rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, ka përcjellë në Prokurorinë e Përgjithshme një ankim ndaj vendimit të shfuqizimit të drejtuesit të prokurorisë.
- v. Në datën 12.3.2015, Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur mospranimin e ankimit të znj. Nushi ndaj vendimit të shfuqizimit të drejtuesit të prokurorisë.
- vi. Veç të tjerash, në vendimin e tij, Prokurori i Përgjithshëm shprehet se hetimi duhet të përfundojë pasi janë kryer të gjitha veprimet hetimore në mënyrë të plotë dhe të gjithanshme, të nevojshme për të mundësuar një vlerësim ligjor të thelluar të provave të grumbulluara, në funksion të marrjes së një vendimi përfundimtar të drejtë dhe të bazuar.
- vii. Por, nga studimi i dosjes rezultojnë se detyrat e lëna në vendimin e drejtuesit janë të një rëndësie të veçantë për hetimin e plotë të rastit të ndodhur. Gjithashtu, edhe veprimet e tjera ishin të domosdoshme për t’u kryer, pasi personi i dyshuar mund të ketë kryer edhe veprime

të tjera të kundërligjshme, përveç atyre të pasqyruara në kallëzimin penal, të paraqitur nga Posta Shqiptare.

- viii. Në datën 26.6.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Mat, ka pranuar kërkesën e paraqitur nga prokurori A. M. dhe ka vendosur masën e sigurimit personal “*arrest në burg*” në ngarkim të të pandehurit S. Xh.
- ix. Lidhur me këtë procedim, subjekti ka shpjeguar se nga ana e saj janë kryer të gjitha veprimet hetimore, që ajo i ka vlerësuar të nevojshme. Për sa i takon mosdhënies së urdhrin të arrestit, ajo është shprehur se nuk e ka bërë atë, pasi nga sistemi *TIMS* kishte rezultuar se personi në fjalë gjendej jashtë territorit të Shqipërisë; gjithashtu ka shtuar se vlerësimet e bëra nga drejtuesit e prokurorisë nuk mund të merren në konsideratë nga Komisioni, pasi reforma e fundit u ka dhënë autonomi dhe pavarësi veprimi hetimor prokurorëve të cilët janë zotër të dosjeve.
- x. Komisioni, bazuar në sa më lart, vlerëson se në kryerjen e veprimeve hetimore për këtë çështje janë evidentuar një sërë mangësish profesionale të subjektit të rivlerësimit, të cilat kanë ndikuar në veprimtarinë hetimore në fjalë, siç janë specifikuar më sipër dhe evidentuar nga drejtuesi i prokurorisë në vendimin e tij të shfuqizimit të vendimit të subjektit – si dhe të konfirmuara edhe nga vlerësimi dhe vendimi i Prokurorit të Përgjithshëm. Nga këto mangësi hetimore është motivuar ndërhyrja e drejtuesit të institucionit për të bërë të nevojshëm vijimin e hetimit dhe për të urdhëruar hetime shtesë.
- xi. Lidhur me urdhrin e arrestit, evidentohet fakti që ky veprim hetimor është i domosdoshëm jo vetëm për kapjen e mundshme të personit të kërkuar në territorin shqiptar, por edhe për të vijuar më tej me urdhrin e kërkimit ndërkombëtar – siç është vepruar më pas në të njëjtin rast – nëpërmjet të cilit mundësohet edhe kërkesa për ekstradimin e të larguarit/kërkuarit.

Nga një vlerësim i përgjithshëm i kriterit për aftësitë profesionale, trupi gjykues çmon se faktet, rrethanat, veprimet, mosveprimet e subjektit, të dhënat e disa prej dosjeve të studiuara, si dhe konstatimet dhe vlerësimet e lartpërmendura – të kryera edhe nga eprorët e subjektit lidhur me mangësitë në hetime të kësaj të fundit – përbëjnë veprime apo mosveprime që bien ndesh me parashikimet procedurale dhe, duke qenë të një rëndësie të veçantë dhe me influencë të madhe në raport me vendimmarrjet e subjektit, të cilat kanë çuar në mënyrë të përsëritur në mbyllje hetimesh të paplota dhe në cilësimin e veprave penale në mënyrë jokorrekte dhe jo në përputhje me rrethanat dhe faktet konkrete apo me dispozitat ligjore, çon në aplikimin e pikës 4, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Gjithashtu, Komisioni çmon se nga një vlerësim tërësor i të gjitha problematikave të pasqyruara deri këtu në lidhje me të tria kriteret, të cilat ndërthurin: deklarime të pamjaftueshme në ILDKPKI; mosdeklarimin e plotë në tatime të xhiros vjetore reale të biznesit të familjes; dyshime të arsyeshme për integritetin e figurës, të ngritura nga organet ligjzbatuese dhe të konfirmuara nga informacioni i konsultuar/lexuar nga anëtarët e trupit gjykues, por jo të provueshme plotësisht; mangësitë profesionale të përsëritura dhe dyshime të arsyeshme për favorizime të personave nën hetim, përbëjnë shkaqe të mjaftueshme për cenimin e besimit të publikut në figurën e prokurorit dhe, më gjerësisht, në sistemin e drejtësisë. Për rrjedhojë, në rastin konkret, duhet aplikuar edhe pika 5, e nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, duke mbajtur parasysh që:

A. Lidhur me kriterin e pasurisë subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pamjaftueshme në deklaratën “Vetting” dhe në deklaratat periodike dhe nuk ka justifikuar në mënyrë bindëse – mospërputhjen e kësaj të fundit me deklaratat periodike, lidhur me pasuritë, sidomos për sa i përket burimeve financiare nga biznesi i bashkëshortit – sipas parashikimeve të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, subjekti nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e deklarimit të pasurisë dhe duhet aplikuar pika 5, e nenit D, e Aneksit të Kushtetutës.

B. Në lidhje me kontrollin e figurës, trupi gjykues në mungesë të provueshmërisë së plotë të dyshimeve të ngritura, nuk i konsideron të mjaftueshëm elementet në nivel indice dhe dyshimesh në dispozicion, për të konkluduar dhe konsideruar subjektin e rivlerësimit, të papërshtatshëm për vazhdimin e detyrës.

C. Në lidhje me aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit janë konstatuar mangësi profesionale të përsëritura dhe shkelje procedurale, për shkak të të cilave nuk arrin nivelin kualifikues, të kërkuar sipas germës “c”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar pika 4, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.

D. Nga vlerësimi tërësor dhe, kryesisht për sa i takon aspektit etiko-profesional, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe, për rrjedhojë, duhet aplikuar edhe pika 5, e nenit 61, e ligjit nr. 84/2016.

Në këto kushte trupi gjykues, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe bindjen e brendshme, arrin në konkluzionin që subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, me funksion prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës, në nenin D, të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të germës “c”, të pikës 1, të nenit 58, dhe të pikave 3, 4 dhe 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Alketa Nushi, me funksion prokurore/drejtuese në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kukës.
2. Vendimi i arsyetuar me shkrim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 27.6.2019.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Etleda Çiftja
Kryesuese

Lulzim Hamitaj
Relator

Firdes Shuli
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka